

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
PML 202/2013  
Date: 5 shkurt 2014

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Timo Vuojolahi si kryetar i kolegjit, gjyqtarës së Gjykatës Supreme Nesrin Lushta dhe gjyqtarit të EULEX-it Bertil Ahnberg dhe Emine Mustafa si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga këshilltari ligjor e EULEX-it Adnan Isufi, në cilësi të procesmbajtësit, në lëndën penale P.nr 488/08 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës kundër të pandehurit:

" B.H. emri i babait xxx emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës " xxx i lindur më xxx ai, me vendbanim të fundit në fshatin xxx shqiptar i Kosovës, i xxx, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje mestrarë ekonomike, pa dosje të mëparshme penale, në paraburgim prej 21 janarit 2008 lidhur me një procedurë tjetër penale, dhe pas aktgjykimit të formës së prerë në vitujtje të dënimit,

i akuzuar për kryerje të veprave penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje, në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 4, 9 dhe 11 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës, lëndim i rëndë trupor në bashkëkryerje, në kundërshtim të nenit 154 paragrafit 1 të KPK-së, dhe shkaktim i rrezikut të përgjithshëm në bashkëkryerje, në kundërshtim të nenit 291 paragrafit 1, 5 dhe nenit 23 të KPK-së, dhe i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për kryerje të veprave penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje, dhe për lëndim të rëndë trupor në bashkëkryerje, me njëzetepesë (25) vjet burgim afatgjatë, tani para Gjykatës Supreme të Kosovës, në pritje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmerisë,

Duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmerisë të paraqitur nga avokati mbrojtës M.H. në emër të të pandehurit B.H. në kundërshtim të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (P nr 488/08) të datës 22 shtator 2009, kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Ap-Kz nr 246/2010) të datës 25 maj 2012 dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Api-Kzi nr 06/2012) të datës 16 janar 2013.

Pas seancës së mbajtur më 5 shkurt 2014, në përputhje me nenet 451 dhe 454 dhe 455 të Kodit të Procedurës Penale (tash e tutje "KPK") lëshon këtë:

## AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmerisë e paraqitur nga avokati mbrojtës M.H. në emër të të pandehurit B.H. kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P nr 488/08) të datës 22 shtator 2009, kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap-Kz nr 246/2010) të datës 25 maj 2012 dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës (Api-Kzi nr 06/2012) të datës 16 janar 2013, refuzohet si e pabazuar.

## ARSYETIM

### I. Historia e procedurës

Fshite verëmtar se më 24 shtator 2007, i pandehuri B.H. iu dënuar me bashkëkryerje me të pandehur të tjerë kanë vendosur dhe kanë shpërblyer një mjet të

improvizuar shpërthyes në katë përdehes të një lokali në avonynë Bill Clinton. Shpërthimi rezultoi me vdekjen e N. M. dhe P. S. Të tjera disa individë të tjerë X.H.S., V.Z., L.N., G.S., E.H., N.H., F.B., L.K. dhe S.H.S. pesuan lëndime të rënda trupore.

Pas përfundimit të hetimit, më 12 gusht 2008, Prokurori ka ngritur aktakuzë lidhur me këtë lëndë penale. Aktakuza u konfirmua më 2 shkurt 2009.

Më 22 shtator 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë shpalli të pandehurin B.H. fajtor për kryetje të veprave penale vrasje e rëndë në shkelje të nenit 147 par 4, 9 dhe 11 të KPK-së, lëndim i rëndë trupor, në shkelje të nenit 154 par 1 të KPK-së dhe shkaktrim i rrezikut të përgjithshëm, në shkelje të nenit 291 par 1 dhe 5 të KPK-së, dhe shqiptoi dënimin unik me 25 vjet burgim afatgjatë.

Më 25 maj 2012, Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur lidhur me ankesën kundër aktgjyqimit të shkallës së parë, ndryshoi aktgjykimin e ankimuar duke vërtetuar se pika 3, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm ishte konsumuar nga pika 1 vrasja e rëndë. Aktgjykimi ishte vërtetuar në pjesët e tjera.

Më 16 janar 2013, Gjykata Supreme e Kosovës refuzoi ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit B.H. kundër aktgjyqimeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P nr 488/08) të datës 22 shtator 2009, dhe kundër aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap-Kz nr 246/2010), të datës 25 maj 2012.

Më 28 shtator 2012, avokati mbrojtës M.H. paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjyqimeve të lartpërmendura.

Zyra e Prokurorit të Shtetit (ZPShK) me mendimin e vet KLMP II nr 145/2013, të datës 26 nëntor 2013, i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës ta pranojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës dhe t'i anulojë aktgjykimet e ankimuar dhe ta kthejë lëndën në rigjykim.

## II. Procedura para Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Pas vlerësimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë Gjykata Supreme vërtetoi si në vijim:

- Gjykata Supreme e shqyrtoi kërkesën në seancën e kolegjit. Nuk ishte e nevojshme të kërkohet përgjigje nga pala kundërshtare.
- Kërkesa është paraqitur në gjykatë kompetente dhe nga personi i autorizuar, në përputhje me nenin 433 paragrafin 1 dhe nenin 434 paragrafin 1 të KPK-së.
- Kolegji nuk ka mundur ta gjejë se kur i është dorëzuar të pandehurit aktgjykimin i Gjykatës Supreme i datës 16 janar 2013. Prandaj, konsiderohet se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e paraqitur brenda afatit ligjor kohor, në përputhje me nenin 433 paragrafin 2 të KPK-së.
- Kolegji konsideron se kërkesa është e lejueshme.

2. Aktgjykimet në këtë lëndë penale janë kundërshtar, fillimisht, për shkak të shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale, dhe së dyti për shkak të shkeljes së ligjit penal. Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmerisë, avokati mbrojtës pretendon në një numër të caktuar të shkeljeve, të cilat paraqiten si në vijim:

- Përbërje e gabuar e trupit gjykues (nenet 345, 359 dhe 403 par 1, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, *tash e tutje "KPPK"*, ligji në fuqi në kohën e procedurës së mëparshme,
- Aktgjykimet bazohen në prova të papranueshme, sikurse analiza e ekspertit (neni 176 par 1, neni 237 par 2 dhe neni 403 par 1 pika 8 e KPPK-së).
- Aktgjykimet i tejkalojnë aktakuzën e ngritur fillimisht nga prokurori (nenet 386 dhe 403 par 1 pika 10 e KPPK-së)
- Aktgjykimeve u mungon baza dhe arsyetimi i fakteve është në kundërtënie në mes të provave të paraqitura në procedurë. Dëshmitë e dëshmitarëve "Y." dhe "D." dhe "V.Z." ndryshojnë shumë nga dëshmitë e dëshmitarëve "G." dhe "B." dhe "Z.", kurse dëshmia e dëshmitarit "V.Z." madje as nuk është përshirë në arsyetimin e aktgjykimit (nenet 387 par 2, 396 par 7 dhe 403 par 1 pika 12 e KPPK-së).
- Kualifikimi ligjor i veprës, motivet dhe dashja: Është bërë shkelje e ligjit penal për shkak të kualifikimit të gabuar të veprës penale. I pandehuri nuk kishte qëllim të privonte nga jeta i N.M. dhe i P.S. siç pohohet në aktgjykim, por vetëm t'i shkaktonte dëme restorantit dhe t'i rikësonte pronarët. Në arsyetimin e aktgjykimeve ka një mospërputhje në mes të motiveve të vërtetuara dhe të dashjes.

3. Kolegji gjen se katër pretendimet e para ishin ngritur më herët gjatë procedurës së mëparshme, dhe të gjitha ishin refuzuar si të pabazuara.

4. Kolegji gjen se aktgjykimet e kundërshtuara të lëshuara në procedurën e mëparshme nuk kërkojnë intervenim sipas detyrës zyrtare. Prandaj, në përputhje me nenin 436 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon.

### III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

#### A. Shkeljet e pretenduara të dispozitave të procedurës penale

1. Avokati mbrojtës N.H fillimisht pretendon në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse ishte ndryshuar përbërja e trupit gjykues e Gjykatës së Qarkut por shqyrtimi gjyqësor nuk kishte filluar rishtas. Sipas avokatit mbrojtës, kjo do të thotë se janë shkelur dispozitat e nenet 345 dhe 354-359 të KPPK-së.

Kolegji vëren se përbërja e gabuar e trupit gjykues përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale lidhur me përbërjen e kolegjit janë të natyrës "absolute". Si të tilla, gjykata është e obliguar që ta shqyrtojë ligjshmerinë e kolegjit që ka lëshuar aktgjykimin sipas detyrës zyrtare pavarësisht se a e kanë ngritur palet këtë çështje.

Në këtë kontekst, neni 345 paragrafi 1 i KPPK-së thotë: "Kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shpreh fillon rishtas. Por, në rastin e tillë, trupi gjykues pas shqyrtimit të palëve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren në veshje nëse

*... në të mos bëhet këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor apo të lexohet procesverbalet e këqyrjes së vendit."*

Vlen të përmendet se Gjykata Supreme vazhdimësi ka rishikuar dhe shqyrtuar këtë pikë në mënyrë shteruese gjatë procedurave të mëparshme dhe në gjithnjë ka mbajtur qëndrimin, me të cilin ky kolegji pajtohet, se përbërja e trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut ishte në përputhje me ligjin. Përveç kësaj, siç ka vërtetuar Gjykata Supreme më 16 janar 2013 (shih kapitullin Gjetjet e Gjykatës, pika 5, faqet 6-7), mënyra se si është vazhduar shqyrtimi gjyqësor në asnjë mënyrë nuk përbën shkelje të të drejtave të palëve në procedurë.

Duke adresuar çështjen e zëvendësimit të anëtarit të trupit gjykues, ky kolegji i referohet procesverbalet të shqyrtimit gjyqësor ku mund të shihet se palët në procedurë shprehimisht janë ftuar të komentojnë nëse kanë ndonjë vërejtje lidhur me përbërjen e trupit gjykues. Kryetari i trupit gjykues gjithashtu shprehimisht i ka ftuar të gjitha palët të deklarojnë se a duhet të konsiderohen deklaratat e dhëna me parë si të lexuara apo palët dëshirojnë t'i lexojnë të gjitha deklaratat edhe një herë. Palët në procedurë nuk kanë bërë asnjë vërejtje lidhur me këtë çështje. Të gjitha palët, duke përfshirë edhe avokatin mbrojtës **M.H.**, janë pajtuar që deklaratat të konsiderohen si të lexuara për hatër të përshpejtimin të procedurës në këtë lëndë. Pasi nuk u bë asnjë vërejtje dhe pasi palët në procedurë u pajtuan, gjykata i konsideroi si të lexuara deklaratat të cilat ishin dhënë para trupit të mëparshëm gjykues.

Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë plotësisht i është përmbajtur kërkesave të dispozitës së përmendur.

Kolegji gjen me vend të theksoj se çështjet lidhur me ndryshimin e përbërjes së trupit gjykues dhe me leximin e deklaratave nuk ishin kundërshtuar deri në përfundimin e procedurës gjyqësore. Vetëm pas përfundimit të gjyqimit avokati mbrojtës ka filluar të kundërshtojë në lidhje me përbërjen e gabuar të trupit gjykues, duke e vënë në pyetje përbërjen e trupit gjykues.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk gjen asnjë rrethanë të re që vë në dyshim paanshmërinë e anëtarit të ri të trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në këtë lëndë, si dhe nuk gjen asnjë parregullsi sa i përket përbërjes së trupit gjykues ose zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor lidhur me çështjen e ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se ky pretendim është i pabazuar.

2. Së dyti, avokati mbrojtës **M.H.** pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar është i bazuar në dëshmi të papranueshme sikurse ekspertimi i gjurmëve të mbetjes së eksplozivit në veturën Toyota Land Cruiser me regjistrim 093 KS 073 (*analizat e kryera në Gjermani*), në shkelje të nenit 176 par 1 të KPPK-së. Sipas avokatit mbrojtës, prokurori nuk kishte kompetencë të urdhërojë në mënyrë të pavarur ekspertin që të bëjë ekspertimin; prandaj është bërë shkelje e nenit 237 par 2 të KPPK-së. Më tutje, pretendohet se konstatimet e ekspertit nuk janë as të besueshme sepse mostrat ishin marrë nga vetura katër (4) muaj e 15 ditë pas incidentit dhe vetura ishte përdorur në ndërkohë.

Fjalja e parë e nenit 176 paragrafi 1 të KPPK-së thotë: "Ekspertimin e urdhëron gjykata në shkrim në bazë të kërkesës së prokurorit publik, të mbrojtësit ose sipas detyrës zyrtare."

Neni 153 paragrafi 1 i KPPK-së thotë: "Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu."

Sic ka theksuar Gjykata Supreme në aktgjykimin e datës 16 janar 2013, KPPK-ja nuk parasheh se ekspertimi i kërkuar pa urdhër të gjykatës me shkrim është e papranueshme.

Në Kosovë, si në çdo shtet tjetër, Prokurori Publik është autoriteti legjitim i pakontestueshëm për të reaguar çdo herë kur ka informata se ka ndodhur një krim. Kjo gjithashtu do të thotë se Prokurori ka për obligim që t'i mbledh të gjitha informatat të cilat mund të jenë të dobishme për zhvillimin efektiv të procedurës penale. Dispozitat e KPPK-së nuk përcaktojnë asnjë kufizim ligjor për asnjërin palë për të paraqitur prova në cilëndo fazë të procedurës nëse provat janë relevante dhe nëse paraqiten në përputhje me rregullat për administrimin e provave. Në këtë lëndë, avokatët mbrojtës pretendojnë se thjeshtë për shkak se Prokurori nuk ka marrë një urdhër nga gjykata për ekspertizë, ky fakt e bën provën automatikisht të papranueshme. Sidoqoftë, nuk ka asnjë indikacion, madje as nuk pretendohet nga avokati mbrojtës, se autoritetet kanë keqpërdorur autorizimet në çfarëdo mënyre apo kanë shkelur të drejtat e të pandehurit gjatë fazës së hetimeve.

Sa i përket nenit 237 paragrafi 2 të KPPK-së të referuar në kërkesë, kolegji thekson se kjo dispozitë ka të bëjë me ndërhyrjen në privacinë e individit i.e. examinitimet fizike post mortem, examinitimet psikiatrike, molekulare e gjenetike dhe analizat e ADN-së. Këtu nuk kemi një situatë të tillë.

Si rrjedhojë, kolegji e gjen këtë argument të mbrojtjes të pa meritë.

3. Avokati mbrojtës pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara kanë tejkalluar aktakuzën e paraqitur fillimisht nga Prokurori kur gjoja motivi ka qenë privimi nga jeta i N.B. at sepse ai i dinte kryerësit e shpërthimit në restorantin S. Më tutje, avokati mbrojtës pohon se gjykata e shkallës së parë është përqendruar tërësisht në motivet, gjersa aktgjykimi P. nr. 459 i datës 7 shkurt 2011 (rasti "Dubrava") nuk i ka pranuar këto motive.

Gjykata Supreme e Kosovës vëren se pjesa e parë e argumentit nuk është fare e kuptueshme. Sidoqoftë, sa i përket çështjes së motivit dhe tejkalimit të aktakuzës, ky kolegji së pari i referohet aktgjykimit të mëparshëm të Gjykatës Supreme në këtë lëndë (aktgjykimi 25 maj 2012, faqet 12-14, dhe aktgjykimi 16 janar 2013, pika 8 në faqet 7-8). Së dyti, mund të shtohet se gjykata e shkallës së parë ka bërë analizë në arsyetim vetëm në lidhje me lëndën në fjalë. Faktet dhe rrethanat e njëjta mund të jenë relevante në dy procedura penale të ndryshme, dhe kjo do të thotë se ato duhet të vlerësohen në të dy lëndët- dhe është e mundur që ato të vlerësohen ndryshe. Kjo nuk ka asgjë të bëjë me çështjen e tejkalimit të aktakuzës. Dy lëndë penale të ndara janë dy lëndë të ndryshme, dhe çështja e tejkalimit të aktakuzës duhet të adresohet ndaras, në kuadër të secilës lëndë.

Në këtë lëndë, ky kolegji pajtohet me gjetjet e Gjykatës Supreme në aktgjykimin e datës 25 maj 2012 se Gjykata e Qarkut ka vendosur në lidhje me ekzistimin e aktit kriminal p.sh., shpërthimin dhe përgjegjësinë e të pandehurve, në bazë të fakteve të përshkruara në aktakuzë. Prandaj, aktgjykimi nuk e tejkallon aktakuzën. Për më tepër, ky kolegji nuk gjen asnjë kundërtënie dhe/apo mospërputhje në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjyqimeve të kundërshtuara, arsyetimi ofron sqarime të mëtutjeshme ashtu siç kërkohej me dispozitat e procedurës penale. Gjykata nuk aktyrohet nga aktakuzat në

lidhje me arsyetimin e aktgjykimit e kjo as nuk mund të konsiderohet si tejkalim i aktakuzës. Pjesa e arsyetimit se si gjykata ka arritur në përfundim është në diskrecion të gjykatave. Prandaj, nuk është konstatuar asnjë mangësi në lidhje me dispozitivet e aktgjyqimeve të kundërshtuara apo tejkalim të aktakuzës siç është pretenduar nga avokati mbrojtës. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se në këtë lëndë dispozitivet e aktgjyqimeve të kundërshtuara janë të qarta në mënyrë të mjaftueshme kurse në pjesën e arsyetimit gjykatat kanë dhënë arsye të thella të cilat e kanë shtyrë gjykatën në një përfundim të tillë.

Si rrjedhojë, kolegji e gjen këtë argument të avokatit mbrojtës të pa meritë.

4. Avokati mbrojtës pretendon se tri aktgjykimet e kundërshtuara janë kundërthënëse në mes asaj që është paraqitur në arsyetim, përmbajtjes së parashtrësave, procesverbalit të deklaratave të dhëna gjatë procedurës dhe vetë parashtrësave dhe procesverbalit. Në mënyrë më specifike, avokati mbrojtës pohon se deklaratat e dëshmitarëve "D." dhe "B." dhe "Z." ndryshojnë shumë nga deklaratat e dëshmitarëve "G." dhe "Z." kurse deklarata e dëshmitarit "Z." madje as nuk është përmendur në arsyetimin e aktgjykimit. Kjo sipas avokatit mbrojtës është në shkelje të nenit 387 paragrafit 2 dhe nenit 396 paragrafit 7 të KPPK-së.

Gjykata Supreme gjen se edhe pse avokati mbrojtës nuk ka pretenduar shprehimisht, në të vërtetë, çështja pjesërisht i referohet vërtetimit të gjendjes faktike. Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës është kufizuar në vlerësimin e saj sipas nenit 437 të KPPK-së i cili përcakton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. Sidoqoftë, pretendimi në lidhje me vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve do të adresohet deri në atë masë që lidhet me rregullat e procedurës për procedurën e provave.

Fillimisht, Gjykata Supreme e Kosovës vëren se pretendimet e avokatit mbrojtës në lidhje me këtë pikë janë adresuar në procedurën e apelit gjatë shkallës së dytë dhe të tretë. Tripi gjykuesi dhe gjykatat e apelit kanë shqyrtuar në hollësi pretendimet e ngritura nga avokati mbrojtës dhe kanë dhënë analiza të mjaftueshme të deklaratave të dëshmitarëve dhe sqarime në lidhje me mospërputhjet në mes të dëshmitarëve të ndryshëm dhe/apo kundërthëniet e dëshmitarëve të cilët kanë dhënë deklarata në faza të ndryshme të procedurës.

Mund të jenë dy çështje kryesore në lidhje me deklarata e dëshmitarëve në lidhje me këtë pikë të ngritur nga avokati mbrojtës; së pari, nëse provat janë marrë në pajtim me rregullat e provave, dhe së dyti, nëse provat në të cilat është mbështetur gjykata janë të besueshme.

Në lidhje me çështjen e parë, në mënyrë që provat të jenë të pranueshme, gjykata duhet të marrë parasysh kushtet për përdorimin e provave. Që është, nëse autoriteti i cili zhvillon procedurën i është përmbajtur rregullave të procedurës; nëse personi kundër të cilit janë paraqitur provat ka pasur të drejtën dhe mundësinë që të marrë në pyetje të tërthortë deklartuesin; nëse avokati mbrojtës ka pasur mundësinë që të paraqes kundërshtimin e tij dhe nëse provat e prezantuara janë relevante.

Në këtë lëndë, është evidente se avokati mbrojtës dhe i pandehuri kanë pasur mundësi të mjaftueshme që t'i paraqesin kundërshtimet e tyre dhe t'u parashtrorin pyetje dëshmitarëve, e cila në fakt nuk kontestohet madje as nga avokati mbrojtës. Prandaj, paraqitja e provave nuk përben asnjë shkelje të dispozitave të procedurës penale.

Në lidhje me besueshmërinë e dëshmitareve, Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me avokatin mbrojtës se prania e ndonjë kundërthënie në deklaratat e dëshmitareve e ben besueshmërinë e tyre të dyshimtë. Gjykata nuk duhet të trajtojë mosperputhjet e vogla të një deklarate të caktuar të një dëshmitari si diskreditim i vlerës provuese të deklaratave të dëshmitareve të tjetër kur ajo deklaratë përputhet në esencë me detaje të njajftueshme. Mosperputhjet dhe kundërthëniet në provat e dëshmitareve mund të rezultojnë nga proceset e natyrshme psikologjike të perceptimit njerëzor, posaçërisht të dëshmitareve të cilët kanë pësuar ngjarje traumatike dhe të cilët për shkak të rrethanave procedurale është dashur të japin deklarata disa herë para autoriteteve në lidhje me ngjarjen e njëjtë. Në këtë lëndë, fakti se disa dëshmitarë në deklaratat e tyre kundërshtojnë dëshmitarët e tjerë nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për t'i bërë deklaratat e dëshmitareve të tjerë të mosbesueshme. Deklarata e dëshmitarit nuk mund të konsiderohet në mënyrë arbitrare si e njëanshme vetëm për shkak se një dëshmitar tjetër ka deklaruar diçka ndryshe përdërisa gjykata me vëmendje, kujdes dhe paanshmëri merr parasysh secilën prej tyre ndaras dhe në lidhje me njëra tjetrën dhe në lidhje me të gjitha provat tjera në lëndë. Në lidhje me besueshmërinë, është obligim i gjykatës që të vlerësojë se çfarë është dhe çfarë nuk është relevante në lëndë. Gjykata, në pajtim me vlerësimin e saj duhet të pranojë dhe marrë parasysh çdo provë të pranueshme që e konsideron relevante dhe që ka vlerë provuese në lidhje me procedurën penale specifike si dhe të sigurojë që lënda të ekzaminohet në mënyrë të drejtë dhe të hollësishme në pajtim me rregullat e provave të përcaktuara sipas kodit të procedurës.

Në mënyrë specifike, në lidhje me deklaratat e dëshmitareve "X" dhe "D" dhe "V.Z", Gjykata Supreme gjen se në mënyrë që të kontestohet besueshmëria e një dëshmitari, është e nevojshme që të paraqiten dhe vërtetohen disa rrethana specifike të cilat në mënyrë të arsyeshme dhe objektive do ta bënin paanshmërinë e dëshmitarit të caktuar të mosbesueshme. Besueshmëria e një dëshmitari nuk mund të kontestohet thjeshtë në bazë të dyshimit, përveç nëse paraqiten dhe vërtetohen fakte të sakta dhe të qarta të cilat tregojnë anshmëri të tillë.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka gjetur asnjë rrethanë specifike e cila do ta bënte paanshmërinë e atyre dëshmitareve të dyshimtë. Dëshmitarët nuk kanë treguar se ju mungon paanshmëria në vlerësimet e tyre as nga analiza subjektive e as ajo objektive.

Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit se gjykatat e mëparshme kanë dhënë sqarime të njajftueshme dhe arsye bindëse në lidhje me deklaratat në të cilat janë mbështetur dhe në mënyrë të duhur kanë adresuar kundërshtimin e ngritur nga mbrojtja.

### B. Shkeljet e pretenduara të dispozitave të Kodit Penal

5. Avokati mbrojtës pretendon se ekziston shkelje e ligjit penal për shkak të cilësimit juridik të gabuar të aktit kriminal dhe aplikimit të gabuar të dispozitave të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së). I pandehuri është liruar nga vepra penale shkaktrim i trezitkut të përgjithshëm pasi që është absorbuar nga vepra penale e vrasjes. Avokati mbrojtës M.H pohon se, sipas arsyetimit të aktgjyqimeve të mëparshme, i pandehuri nuk ka pasur për qëllim që ta privoj nga jeta "NoBo" in dhe "P-So" por t'i shkaktoj dëmeve restaurantit dhe t'i frikësoj pronarët. Prandaj, në veprimet e të pandehurit, nëse merren siç kanë theksuar gjykatat e mëparshme, nuk ekzistojnë elemente të dashjes direkte apo madje të dashjes eventuale për veprën penale të vrasjes. Vepra penale në rast të tillë do të mund të cilësohet si një formë e rëndë e shkaktrimit të trezitkut të përgjithshëm, në kundërshtim të nenit 201 paragrafi 1 dhe 5, në lidhje me nenin 23 të

Kodin Penal të Kosovës që ka rezultuar në vdekjen dhe lëndimin e individëve të cilët nuk ishin cak.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me avokatin mbrojtës. Objekti mbrojtës është e ndryshëm në veprën penale të Vrasjes dhe në veprën penale Shkaktim i rrezikut të Përgjithshëm. Në veprën penale të Vrasjes objekti mbrojtës është jeta dhe integriteti i individit. Edhe pse vepra penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm mund të rezultojë në vdekjen apo lëndimin e një apo disa personave, vlera kryesore e mbrojtur nuk është integriteti i individit. Nuk ka asnjë dyshim se vepra penale e Vrasjes mund të kryhet duke përdorur eksploziv.

Neni 15 i KPK-së përcakton:

- (1) Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale.
- (2) Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj.
- (3) Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj.

Gjykata Supreme e Kosovës thekson se kryerësi konsiderohet se ka pranuar shkaktimin e pasojës kur ai/ajo nuk është përmbajtur nga veprimi edhe nëse ai/ajo e ka ditur se pasoja mund të ndodh. Për qëllime të dashjes, saktësia e magnitudës së pasojës nuk është relevante. Ajo që është e rëndësishme është se kryerësi a ka qenë i vetëdijshëm ose, duke pasur parasysh karakteristikat personale të kryerësit, a ka mundur ta dijë se si rezultat i veprimit të tij/saj mund të ndodh pasoja e ndaluar, dhe megjithëkëtë ka vendosur që të vazhdoj me veprimet e tij/saj.

Në lëndën në fjalë, siç është theksuar nga Gjykata e Qarkut (shih aktgjykimin nën titullin "Përfundimi"), është e qartë se i pandehuri **B.H.** ka ditur se ka konsumator të pranishëm në harin Prestige. I pandehuri, si polic, ka qenë i vetëdijshëm dhe ka mundur ta dijë se si rezultat i eksplozivit mund të shkaktohet vdekja dhe/apo lëndimi i individëve. Nuk ka asnjë dyshim se ai e ka paraparë mundësinë që shpërthimi do të mund të shkaktohej vdekjen dhe lëndimin trupor të njerëzve në afërsi të vendit të shpërthimit. Megjithëkëtë, ai ka vazhduar me veprimet e tij dhe ka marrë pjesë në vendosjen e eksplozivit.

Ky kolegji pajtohet me aktgjykimin e mëparshëm dhe konsideron se i pandehuri **B.H.** ka vepruar me dashje eventuale. Prandaj, aktgjykimin i ankimuar i Gjykatës Supreme të Kosovës mbetet pa gabime në lidhje me cilësimin e veprës penale.

#### IV. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Për arsyet e lartpërmendura, sipas nenit 437 të KPP-së, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitiv.



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
PML 202/2013, 5 shkurt 2014

Kryetar i kolegjit:

\_\_\_\_\_  
Timo Vuojolahti  
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës:


\_\_\_\_\_  
Adnan Isufi  
Këshilltar ligjor

Anëtarët e kolegjit:

\_\_\_\_\_  
Bertil Ahnborg,  
Gjyqtar i EULEX-it

\_\_\_\_\_  
Nesrin Lushta  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Republika e Kosovës  Republika Kosovo  
KOPJË E KOPJËS E VËRTETON  
KOPJE OTPRAVKA POTVRDJUJE

  
\_\_\_\_\_  
Funtori i autorizuar  
Qeveria e Kosovës